

**BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE**

**VOLUMI 15**

**(JANAR-QERSHOR 2024)**

## **PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE**

<b>1. Vendim nr. 86-2024-631 (579), datë 18.04.2024.....</b>	<b>4</b>
<b>2. Vendim nr. 86-2017-1142 (1041), datë 13.06.2024.....</b>	<b>6</b>
<b>3. Vendim nr.622( 86-2023-916), datë 21.09.2023.....</b>	<b>10</b>
<b>4. Vendim nr.508, datë 26.02.2024.....</b>	<b>11</b>
<b>5. Vendim nr.559(86-2023-834), datë 14.09.2023.....</b>	<b>13</b>
<b>6. Vendim nr. 95 (86-2024-125), datë 01.02.2024.....</b>	<b>15</b>
<b>7. Vendim nr.74, datë 29.01.2024.....</b>	<b>16</b>
<b>8. Vendim nr. 607, datë 19.04.2024.....</b>	<b>18</b>
<b>9. Vendim nr. 778, datë 09.05.2024.....</b>	<b>20</b>
<b>10. Vendim nr.973, datë 06.12.2023.....</b>	<b>22</b>
<b>11. Vendim nr.1077, datë 18.12.2023.....</b>	<b>23</b>

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

### ***Shënim!***

*Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.*

## 1. Vendim nr. 86-2024-631 (579), datë 18.04.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

**Paditës:** Shoqëria "M.H" sh.p.k

**Të paditur:** Drejtoria e Apelimit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë

**Objekti:** Shfuqizimin e pjesshëm të njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 03.08.2016.

Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 30190/1 prot., datë 17.11.2016, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor për sa i përket pikës 3, duke lejuar rimbursimin e TVSH-së kundrejt paditësit.

### **Permbledhje e rrethanave të faktit:**

Shoqëria "M.H" sh.p.k me NIPT L\_\_\_\_\_A është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, me objekt aktiviteti: ndërtimi, operimi, dhe transferimi i hidrocentraleve.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT Tiranë), ka ushtruar kontroll pranë palës paditëse MH shpk në zbatim të lajmërimit për kontroll nr. \_\_\_\_ Prot., datë 07.06.2016. Objekti i kontrollit ka qenë TVSH për periudhën 01.10.2012-30.04.2016, për të saktësuar gjendjen kreditore të shoqërisë, e cila, me kërkesën e datës 03.06.2016, ka kërkuar rimbursimin e TVSH në shumën \_\_\_\_\_ lekë, të krijuar për periudhën 2012/10-2016/4.

DRT Tiranë, në raport kontrollin përfundimtar, ndër të tjera, për sa i përket kërkesës së palës paditëse "M.H" sh.p.k, e ka konsideruar të parimbursueshme shumën prej \_\_\_\_\_lekë, me arsyetimin se: *Shoqëria në momentin e kontrollit është në fazën e studimeve dhe kërkimeve të nevojshme për implementimin e projektit sipas kontratës koncesionare të nënshkruar me Ministrinë. Shoqëria nuk është e pajisur me leje ndërtimi të objektit, çka nuk jep garancinë e nevojshme se do të kryejë shitje të tatueshme.*

Pra, nuk plotësohen kushtet për rimbursimin e TVSh-së sipas nenit 77 të Ligjit nr. 92/2014. Gjithashtu, pala paditëse është penalizuar sipas nenit 115, të Ligjit nr. 9920/2008, në masën 0.06% për çdo ditë të vlerës së TVSH, në shumën \_\_\_\_\_ lekë.

DRT Tiranë, bazuar në raport kontrollin përfundimtar, pasi ka shqyrtuar edhe observacionet e shoqërisë "M.H"sh.p.k, me njoftimin vlerësimin për detyrimet tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 03.08.2016, ka njoftuar shoqërinë për detyrime dhe gjoba në shumën totale prej \_\_\_\_\_ lekë.

Ndaj këtij akti administrative, shoqëria "M.H" sh.p.k., ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor (DAT), e cila, pasi ka shqyrtuar ankimin, me vendimin nr. 30190/1 prot., datë 17.11.2016, ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi.*

Në këto kushte, shoqëria i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila me vendimin nr. 741(80-2017-708), datë 27.02.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se shkaqet e ngritura në ankimin e palës paditëse "M.H" sh.p.k nuk janë të mbështetura në prova dhe në ligj. Për rrjedhojë, vendimi nr. 741(80-2017-708), datë 27.02.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duhet të mbetet në fuqi.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, ndryshe nga sa pretendohet në ankim nga pala paditëse "M.H" sh.p.k, në lidhje me ligjin e zbatueshëm, rrethanat e faktit dhe provat ku palët mbështeten, drejt ka arsyetuar gjykata administrative e shkallë së parë se verifikimi dhe kontrolli i shumë së kërkuar për rimbursim, është i lidhur me procedurat e kontrollit dhe vlerësimit tatimor të përcaktuar në kreun VII dhe X të ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Pra verifikimi dhe kontrolli i shumës së kërkuar për rimbursim nuk mund të tejkalonte kushtet dhe afatet e përcaktuara në këto norma, pasi në të kundërt, do të ndikonte ndjeshëm në ligjshmërinë e kontrollit të kryer.

Ligji nr.92/2014 përcakton qartë se, kreditimi i TVSH-së lejohet nëse blerjet i shërbejnë furnizimeve të tatueshme të bëra apo atyre që do të bëhen në një kohë tjetër në të ardhmen. Kjo vlen edhe në rastin e blerjes së aktiveve të cilat duhet ti shërbejnë furnizimeve të tatueshme, për rrjedhojë të sjellin edhe lindjen e së drejtës së kërkesës dhe miratimit të kreditimit të TVSH-së së paguar, pra pasi nga blera e aktivitetit të rrjedhë kryerja e furnizimit të tatueshëm, i cili nga ana e tij krijon TVSH.

Nga provat e administruara dhe debatuar në gjykim në shkallë të parë, rezulton i drejtë përfundimi i gjykatës administrative të shkallës së parë se pala paditëse "M.H" sh.p.k nuk rezulton që të provojë në këtë gjykim se qëllimi i veprimtarisë ekonomike të pretenduar ka qenë realizimi i transaksioneve të tatueshme, që i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sikurse përcakton neni 77 i Ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" i nxjerrë në zbatim të tij.

Për rrjedhojë, bazuar në arsyetimin dhe përfundimet e parashtruara më sipër në këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit vjen në përfundimin se ankimi i palës paditëse MH shpk, nuk është i bazuar në prova dhe në ligj.

**Vendim:**

*Lënien në fuqi të vendimit nr. 741(80-2017-708), datë 27.02.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

**2. Vendim nr. 86-2017-1142 (1041), datë 13.06.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Shoqëria "B" shpk

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë

**Objekti:** 1.Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. \_\_\_\_ Prot., datë 22.08.2016 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe të vendimit nr.31713 Prot., datë 10.11.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.  
2.Heqjen e gjobës ndaj shoqërisë paditëse në shumën \_\_\_\_ lekë.

**Permbledhje e rrethanave të faktit:**

Shoqëria "B" shpk, është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me objekt aktiviteti: "Aksesorë, tregtim metrazhe me shumicë dhe pakicë, import-eksport, prerje dhe qepje perde, veshje mobilerie". ,shoqëria gjithashtu mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera me objekt të njëjtë ose të ndryshëm të saj".

Në zbatim të Njoftim- Kontrollit nr. \_\_\_\_ Prot., datë 06.06.2016 dhe programit bashkëlidhur tij, inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë kanë ushtruar kontroll tatimor ndaj palës paditëse.

Në përfundim të kontrollit nga inspektori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë është hartuar projekt-raport kontrolli i datës 22.07.2016, i cili i është komunikuar shoqërisë me shkresën nr.\_\_\_\_, datë 29.07.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, duke i bërë me dije subjektit të drejtën që gëzon në bazë të ligjit 9920/2008, për kundërshtimin e rezultateve të kontrollit tatimor, brenda 15 ditëve pas datës së marrjes dijeni për këtë projekt kontroll.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në përfundim të kontrollit tatimor, ka nxjerrë njoftim vlerësimit nr. \_\_\_\_ Prot., datë 22.08.2016 nga ku rezulton se shoqëria është penalizuar me detyrim + gjoba, në shumën gjithsej \_\_\_\_ lekë.

Shoqëria ka paraqitur ankim në Drejtorinë e Apelit Tatimor kundër Njoftim Vlerësimit të sipërcituar, me të cilin ankimon pjesërisht detyrimin e vendosur nga DRT Tiranë, pasi ka pranuar

detyrimin dhe kundërshton gjobën e vendosur në shumën \_\_\_\_\_ lekë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin e saj nr. 31713 prot, datë 10.11.2016 ka vendosur lënien në fuqi të aktit administrativ. Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila me vendimin nr. 3016 (80-2017-3068) datë 10.07.2017 ka vendosur rrëzimin e padisë së palës paditëse shoqëria "B" shpk, si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka nxjerrë njoftim vlerësimin nr. \_\_\_\_ Prot., datë 22.08.2016, me të cilin është njoftuar pala paditëse për detyrimin tatimor + gjoba, në shumën totale \_\_\_\_ lekë.

Lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkimeve të palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit i referohet ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" si dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në nenin 78 të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" janë sanksionuar rregullat e përgjithshme për zbritjen e TVSH-së. Referuar nenit 78 të këtij ligji: *Zbritja e TVSH-së e kryer më parë rregullohet kur është më e lartë apo më e ulët se ajo vlerë për të personi cilën i tatueshëm ka gëzuar të drejtën e zbritjes.*

Në nenin 79 të ligjit nr. 92/2014 janë parashikuar rregullat për zbatimin e rregullimit të zbritjes të TVSH-së.

Në këtë dispozitë parashikohet se:

- 1. Rregullimi i zbritjes së TVSH-së kryhet, veçanërisht, kur, pas deklarimit të TVSH-së, kanë ndryshuar faktorët e marrë në konsideratë për përcaktimin e shumës së TVSH-së së zbritur, si për shembull, në rast se blerjet janë anuluar ose janë përfituar reduktive çmimi.*
- 2. Si përjashtim nga dispozita e pikës 1, të këtij neni, rregullimi i zbritjes së TVSH-së nuk kryhet në rastin e transaksioneve të papaguara tërësisht apo pjesërisht ose në raste shkatërrimi, humbjeje apo vjedhjeje të pasurisë, të provuara apo të konfirmuara sipas procedurave përkatëse ligjore, si edhe në rastin e mallrave të rezervuara për qëllime dhuratash me vlerë të vogël ose për t'u përdorur si mostra apo kampione, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji.*

Pra, sipas kësaj dispozite, rregullimi i zbritjes së TVSH-së kryhet kur, pas deklarimit të TVSH-së, kanë ndryshuar faktorët e marrë në konsideratë për përcaktimin e shumës së TVSH-së së zbritur, si për shembull, në rast se blerjet janë anuluar ose janë përfituar reduktive çmimi.

Ndërkohë që në nenin 80 të ligjit nr. 92/2014 janë parashikuar kriteret e rregullimit të zbritjes së

TVSH-së për mallrat kapitale.

Në zbatim të ligjit nr. 92/2014 është miratuar udhëzim nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", ku ndër të tjera përcaktohen rregullat dhe procedura për daljet jashtë përdorimit të mallrave.

Në kuptim të pikave 2 dhe 3 të nenit 79 të ligjit, nuk kryhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së për daljet jashtë përdorimit të mallrave për shkak se janë të papërdorshme, ose u ka kaluar afati i përdorimit të tyre, të provuara apo të konfirmuara, sipas procedurave përkatëse ligjore e nënligjore.

Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas këtij neni personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për arsye të sigurimit të mallit, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH-në përkatëse.

Shkatërrimi i pasurisë së personit të tatueshëm për shkaqe natyrore të tilla si tërmete, përmbytje, djegie, etj., në raste emergjencash civile sipas legjisllacionit të fushës, ose për shkak teaksidenteve, të cilat janë të verifikueshme dhe të dokumentuara nga institucioni publik përkatës, nuk është objekt i rregullimit të TVSH-së së zbritur.

Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas këtij neni personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për dëmin ose për arsye të sigurimit të mallit, ose vlerë të rikuperueshme për mallin e dëmtuar, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH-në përkatëse.

Do të kryhet rregullimi i TVSH-së së zbritshme, për çdo mall të dëmtuar apo shkatërrim i cili është shkaktuar nga një akt i qëllimshëm i personit të tatueshëm apo dikush që vepron në interes të tij, të tilla si për shembull kur një tatimpagues me qëllim i vë zjarrin mallrave të tij, ose kur shkatërrimi ndodh për shkak të veprimeve të kryera nga personi i tatueshëm në shkelje të dispozitave ligjore përkatëse.

Në kuptim të këtij neni, nuk kryhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së për daljet jashtë përdorimit të mallrave për shkak se janë të papërdorshme, ose u ka kaluar afati i përdorimit të tyre, të provuara apo të konfirmuara, sipas procedurave përkatëse ligjore e nënligjore. Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas këtij neni personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për arsye të sigurimit të mallit, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH-në përkatëse.

Në çështjen objekt gjykimi, Gjykata Administrative e Apelit evidenton se, nuk ndodhemi para faktit të nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave, për shkak se janë të papërdorshme, ose u ka kaluar afati i përdorimit të tyre, për të cilat nuk kryhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së.

Mallrat e palës paditëse janë djegur në magazinë, si rezultat i një shkëndije elektrike, ku dëmi i mallit të djegur është vlerësuar në shumën totale prej \_\_\_\_\_ lekë.

Inspektori tatimor ka evidentuar se, diferenca ndërmjet gjendjes së inventarit sipas kontabilitetit datë 31.12.2015 (në vlerën \_\_\_\_\_ lekë) me gjendjen e bilancit 2015 (në vlerën \_\_\_\_\_ lekë) - diferencë e cila ka rezultuar në shumën \_\_\_\_\_ lekë, rrjedh nga fuqia madhore (Djegje e Magazinës) në datë 13.04.2015, sipas njoftimit që pala paditëse ka bërë në organet tatimore, nëpërmjet shkresës nr.\_\_\_\_ Prot., datë 14.04.2015, si dhe shkresës tjetër plotësim dokumentacioni me nr.\_\_\_\_ Prot., datë 21.04.2015, shoqëruar me procesverbalin e mallrave të dëmtuara nga djegia.

Nga ana e palës paditëse është bërë veprimi kontabël në debi të llogarisë 467 (debitorë dhe kreditorë të tjerë) dhe kredi të llogarisë 605 (blerje, shpenzime mallrash), duke shkarkuar magazinën për mallin e djegur të vlerësuar me kosto blerje, por pa kontabilizuar pakësimin e TVSH-së kreditore (rregullimin e kredisë) që i takon kësaj gjendje fizike në sasi dhe vlerë.

Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, Gjykata Administrative e Apelit e gjen të drejtë konstatimin e inspektorit tatimor, i cili ka marrë në analizë diferencën e inventarit kontabël nga ecuria në vite dhe gjendjes në datë 31.12.2015, me diferencë të vlerësuar me kosto, në shumën \_\_\_\_\_ lekë, duke konstatuar se tatimpaguesi duhet të zbatonte rregullimin e TVSH-së së zbritshme, pasi tatimpaguesi nuk plotëson të gjitha kushtet siç e përcakton ligji për përjashtimin nga aplikimi i saj.

Po kështu, nga tatimpaguesi (pala paditëse) nuk është zbatuar rregulli sipas të cilit, vlera e inventarit të mallrave të dëmtuara e shprehur në procesverbalin e hartuar sipas procedurës të përcaktuar në këtë udhëzim, kontabilizohet duke kaluar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor (2016).

Për rrjedhojë, me të drejtë nga ana e administratës tatimore është konkluduar që sasia e munguar e mallit, e cila është dëmtuar nga zjarri dhe jo si diferencë nga shitje e padeklaruar me faturë tatimore (neni 124), duhet konsideruar dhe vlerësuar si shitje me vlerë kosto blerje për rregullimin e TVSH-së kreditore, në shumën e lartpërmëndur, duke vlerësuar TVSH-në e mbledhshme, e cila në kushtet konkrete, evidentohet vetëm si ulje kreditimi, pasi tatimpaguesi rezulton me TVSH kreditore më të madhe se efekti i TVSH-së së vlerësuar për efekt rregullimi të kredisë.

Nga ky këndvështrim, tatimpaguesi është penalizuar sipas nenit 115 të ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar, për ulje të kreditimit, pasi vlera e munguar është deklaruar, por nuk është sistemuar TVSH-ja, duke iu atij llogaritur detyrime + gjoba në shumën \_\_\_\_\_ lekë.

Gjykata Administrative e Apelit evidenton se, tatimpaguesi pranon rregullimin e TVSH-së së kreditueshme, pra detyrimin, ndërsa kundërshton vetëm gjobën në ankimin administrativ, duke referuar në pikën 4 të nenit 111 të ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Nga interpretim i kësaj dispozite rezulton se gjobat tatimore mund të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore. Në rastin

konkret, nuk ndodhemi para rrethana të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore, me qëllim që të mund të aplikohet heqja e gjobës tatimore në shumën \_\_\_\_\_ lekë.

**Vendim:**

*Lënien në fuqi të vendimit nr. 3016 (80-2017-3068) datë 10.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

**3. Vendim nr.622( 86-2023-916), datë 21.09.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Shoqëria “A.R.H” sh.p.k

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan  
Drejtoria e Apelit Tatimor

**Objekti i padisë:** Kundërshtimi i aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.12.2015 të DRT Elbasan si dhe Vendimit nr.42932/1 Prot., datë 23.02.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Në zbatim të Urdhrit të Punës nr.\_\_\_\_, datë 20.03.2015, inspektorët e zbatimit në Sektorin e Task-Forcës në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, kanë ushtruar kontroll në tatimpaguesin “ARH” sh.p.k, ku kanë mbajtur në vend Akt–Konstatimin me nr. \_\_\_\_\_, datë 23.03.2015 dhe Proces-Verbalin e Gjobës nr.\_\_\_\_\_, datë 23.03.2015 ku është penalizuar subjekti me gjobë në vlerën 500,000 lekë për mosdeklarim punonjësi.

Rezulton se pranë ambienteve të shoqërisë është konstatuar nga ana e inspektorëve një punonjëse e padeklaruar në organin tatimor. Deklarimi i këtij punonjësi pranë organit tatimor nuk është kryer, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, sikurse parashikohet në nenin 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Nga pala paditëse është pretenduar se personi i konstatuar në ambientet e shoqërisë E.S, nuk ka qenë punonjëse e shoqërisë por është paraqitur atë ditë kur është kryer kontrolli për tu njohur me profilin e punës që do të bënte, pasi kishte aplikuar për tu punësuar, si dhe për tu njohur me pjesën tjetër të stafit. Nga ana e shoqërisë është deklaruar me pas në formularët e regjistrimit të punonjësve Esig 027 më datë 23.03.2015, me datë fillimi pune datë 24.03.2015.

**Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin e saj nr.1148(82-2016-1791), datë 28.12.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë, pasi e ka vlerësuar padinë si të pambështetur në prova dhe në ligj, duke konkluduar se është kusht dhe kriter ligjor që deklarimi i punonjësve të

kontraktuar në punë duhet të deklarohet të paktën 24 orë përpara fillimit të aktivitetit. Gjykata e gjen aktin administrativ të nxjerrë nga pala e paditur, si akt administrativ të nxjerrë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit duke mos qenë të prekur nga ndonjë shkak të pavlefshmërisë relative.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e saj nr.622(86-2023-916), datë 21.09.2023, çmon se pretendimet e palës paditëse vijnë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm që ishte në fuqi në momentin e konstatimit të kundravajtjes administrative në datë 23.03.2015, mbi bazën e të cilit është nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan akti administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimin Tatimor nr. \_\_\_\_ Prot., datë 04.12.2015, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr.42932/1 Prot., datë 23.02.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Gjykata vlerëson se, konstatohen shkelje ligjore të kryera nga ana e palës paditëse, pasi rezulton e provuar se nuk është deklaruar në afatin ligjor 24 orë përpara fillimit të punësimit të një punonjësi sipas referimeve ligjore të nenit 119 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga verifikim i kryer në momentin e ushtrimit të kontrollit në datën 23.03.2015, rezulton se personi në fjalë nuk ka qenë i deklaruar në organin tatimor të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës si i punësuar pranë subjektit “Shoqëria Aliu Road House” sh.p.k, me nipt K83211201N , kjo në zbatim të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 119 pika 1 i ndryshuar:

*1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:*

*a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;*

*b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh. Ndryshuar me Ligjin nr. 124/2012 datë 20.12.2012.*

Për sa më sipër, Gjykata çmon se Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.12.2015 nxjerrë nga DRT Elbasan i lënë në fuqi nga Vendimi nr.42932/1 Prot., datë 23.02.2016 i Drejtorisë së Apelimit Tatimor, janë akte administrative të nxjerra konform ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **Vendim:**

- 1. Lënien në fuqi të vendimit nr.1148(82-2016-1791), datë 28.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*
- 2. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.*

### **4. Vendim nr.508, datë 26.02.2024, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria “V” sh.p.k

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan  
Drejtoria e Apelimit Tatimor

**Objekti:** Pavlefshmërinë e Njoftim-Vlerësimit për Detyrimin Tatimor Nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.12.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan si dhe Vendimit nr.8305/1 Prot., datë 16.05.2016, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Në zbatim të Urdhrit të Punës me nr. \_\_\_\_\_, datë 05.09.2015, inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, kanë ushtruar kontroll në tatimpaguesin “V” sh.p.k, ku kanë mbajtur Akt – Konstatimin me nr.\_\_\_\_, datë 12.09.2015.

Pas verifikimeve të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, në sistemin informatik tatimor C@ts, ka rezultuar se personi i gjetur në momentin e ushtrimit të kontrollit nga grupi i inspektorëve të Sektorit të Verifikimit në Terren, S.B me nr. ID G\_\_\_\_S, nuk rezulton i deklaruar si punonjës pranë subjektit “V” sh.p.k.

Kjo vërtetohet edhe nga Deklarata E–SIG 027 Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi periudha tatimore viti 2015, muaji Shtator e deklaruar më datë 04.10.2015 nga vetë subjekti ku pasqyrohet se ka 15 të punësuar por asnjërin me këtë emër.

Nga verifikimi i kryer në momentin e ushtrimit të kontrollit në datën 12.09.2015, rezulton se personi në fjalë i cili është edhe bashkëshorti i zonjës së punësuar pranë kësaj shoqërie, nuk ka qenë i deklaruar në organin tatimor të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës si i punësuar. Personi i konstatuar në vendin e punës ka mohuar punësimin pranë kësaj shoqërie duke pretenduar se ndodhej aty për arsye familjare.

Pala paditëse ka pretenduar pavlefshmërinë absolute të aktit administrative, në referencë të nenit 108 të K.Pr. Administrative.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e saj nr.508, datë 26.02.2024, vendosi pranimin e padisë dhe konstatimin e pavlefshmerisë absolute të aktit administrativ. Gjykata vlerëson përtej pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse se akti administrativ Njoftim Vlerësimit nr.\_\_\_\_ Prot., datë 04.12.2015, i nxjerrë nga DRT Elbasan, ka dalë mbi bazën e një dispozite ligjore që nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së kundravajtjes, ku edhe nëse do të merrej në konsideratë ligji në fuqi në kohën e nxjerrjes së akti administrativ do të konsiderohej akti si i nxjerrë në bazë të një ligji të shfuqizuar si antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata ka vlerësuar se ligji që është aplikuar nga organi tatimor është ligji Nr.99/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare në datë 28.10.2015 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas këtij botimi. Ligji ka hyrë në fuqi pas datës 12.09.2015 kur është konstatuar kundravajtja administrative nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan. Për rredhje, gjykata ka vlerësuar se DRT Elbasan nuk mund të dënonte administrativisht paditësin me një masë administrative që nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së kundravajtjes, duke e konsideruar një veprim të tillë administrativ në kundërshtim flagrant me parimin e ligjshmërisë e per rrjedhojë e bën cdo akt administrativ absolutisht të pavlefshëm.

Gjykata vlerëson se edhe nëse do të merret si ligj i zbatueshëm ligji Nr.99/2015 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, njoftim vlerësimi do të konsiderohet si nje akt absolutisht i pavlefshëm i nxjerrë mbi bazën e një dispozite antikushtetuese, një dispozitë e cila është shfuqizuar referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 08.06.2016.

**Vendim:**

1. *Pranimin e padisë*
2. *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimin Tatimor nr. \_\_\_\_ Prot., datë 04.12.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan si dhe Vendimit nr.8305/1 Prot., datë 16.05.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor.*

**5. Vendim nr.559(86-2023-834), datë 14.09.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** D.R.A.P Gjirokastrë.

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë  
Drejtoria e Apelit Tatimor

**Objekti:** Shfuqizimin e vendimit nr.619/1 Prot., datë 17.06.2022, të Drejtorisë së Apelit Tatimor;  
Shfuqizimin tërësisht të Njoftim Vlerësimit Tatimor nr.\_\_\_\_, datë 27.07.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë;  
Shfuqizimin tërësisht të Vendimit nr.29649/1 Prot., datë 20.10.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Paditësi, pranon se nuk ka dorëzuar në afat deklaratat tatimore të ESIG27 gjatë periudhës 2015 – 2016, prandaj për çdo deklaratë të padorëzuar në afat, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, nga sistemi informatik tatimor C@TS, automatikisht është gjeneruar penalitet në vlerën 10.000 lekë. Nëpërmjet aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 27.07.2016, paditësi ka marrë dijeni për detyrimin që i ka lindur ndaj organit tatimor, për të gjithë periudhën në shumën totale \_\_\_\_lekë, gjobat për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, për deklaram të vonuar të deklaratës ESIG27.

Pasi është njohur me aktin administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.\_\_\_\_ Prot., datë 27.07.2016, duke mos qenë dakord me detyrimin e lindur ndaj organit tatimor, paditësi ka ushtruar të drejtën e tij për ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin nr.29649/1 prot. datë 20.10.2016, ka vendosur *Lënien në fuqi të aktit administrativ.*

## **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. 846, datë 27.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, nuk është i drejtë dhe në përputhje me ligjin material si dhe i bazuar në prova e për rrjedhojë ai duhet të ndryshohet dhe padia të rrëzohet.

Kështu, pagesa me vonesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore është kundravajtje administrative formale, pra, mjafton vonesa në kryerjen e pagesës për ekzistencën e kundravajtjes.

Më konkretisht, personat juridikë dhe fizikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Dy ditë pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, personi juridik dhe fizik duhet të deklarojë në organin tatimor listën e të punësuarve, me pagën përkatëse, përfshirë dhe listën e punonjësve të papaguar të familjes së personit fizik mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Organizatat jofitimprurëse, entet shtetërore, personat “i vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant”, si dhe “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie” regjistrohen në administratën tatimore, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës.

Të larguarit nga puna subjektet duhet t'i deklarojnë zyrtarisht në organin tatimor brenda 10 ditëve kalendarike nga data e largimit. Këto deklarata shërbejnë si deklarime edhe për Inspektoratin Shtetëror të Punës, siç përcaktohet në nenin 22, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006, “Për Inspektoratin e Punës”, të ndryshuar, dhe i vihen në dispozicion këtij të fundit nga ana e administratës tatimore në rrugë elektronike.

Më tej, në referim të dispozitave për rastin konkret provohet se penalizimi i paditësit me gjobë është në përputhje me ligjin pasi nga ana e tij nuk është kryer brenda afatit, deklarimi i punonjësve që kanë filluar punë, sipas formatit të përcaktuar në Vendimin nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” pika 1, shkronja iii). Nga këto deklarata vihet re se data e fillimit të punës për secilin prej tyre, është e njëjtë me datën e deklarimit të tyre si punonjës, për efekt të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Kështu provohet që këta punonjës, janë deklaruar në organin tatimor në të njëjtën ditë që kanë filluar punë dhe jo një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, siç e përcakton saktësisht dispozita ligjore. Me të drejtë deklarimi për këta punonjës është kryer nga paditësi pranë organit tatimor, në mosrespektim të afatit që ka parashikuar ligji, prandaj edhe është penalizuar. Deklarimi i të dhënave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga të gjithë tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë, bëhet vetëm në formë elektronike sipas përmbajtjes së

“Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, bazuar kjo në Udhëzimin nr.23 datë 09.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore” i ndryshuar, në pikën 5 e në vijim.

Me të drejtë Drejtoria e Apelit Tatimor, ka lënë në fuqi aktin administrativ të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, pasi provohet qartë se paditësi ka kryer shkelje të ligjit. Vendimi i dhënë nga Drejtoria e Apelit Tatimor, është marrë në analizë të provave dhe dokumentacionit që vetë paditësi ka depozituar pranë kësaj drejtorie dhe pas hetimit administrativ të kryer nga ana e saj, kjo drejtori ka konkluduar që penalitetet janë vendosur në zbatim të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 119 pika 2.

### **Vendim:**

- 1.Ndryshimin e vendimit nr.846, datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe rrëzimin e padisë.*
- 2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit.*
- 3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.*

### **6. Vendim nr. 95 (86-2024-125), datë 01.02.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës : Shoqëria “T.E”**

**I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë**

**Objekti:** Shfuqizimin e njoftim-vlerësimit tatimor nr. \_\_\_\_ dhe nr.\_\_\_\_, datë 26.05.2016 dhe Vendimin e Drejtorise së Apelit Tatimor nr.\_\_\_\_, datë 14.09.2021.

**Shuma e detyrimit tatimor:** (\_\_\_\_ lekë- detyrime tvsh, tatim-fitimi gjoba dhe kamatëvonesa)

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Me shkresën nr. \_\_\_\_ Prot., datë 28.12.2016, me lëndë “Njoftim kontrolli tatimor“ tatimpaguesi është njoftuar se është planifikuar për tu kontrolluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me objekt: rikontroll i llogaritjes së detyrimeve tatimore tatim-fitimin e vitit 2011-2012, tvsh viti 12/ 2011- 30.06.2013, sigurime shoqërore për vitin 12/ 2011- 30.06.2013 dhe tatime të tjera për të njëjtën periudhë.

Në përfundim të kontrollit, është përpiluar raporti paraprak me detyrimet përkatëse, njoftuar tatimpaguesit, me shkresën nr. \_\_\_\_ Prot., datë 26.05.2016.

Tatimpaguesi ka ndjekur rrugën administrative të ankimit dhe Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin nr. 19626/2, datë 14.09.2016, ka vendosur: ndryshimin pjesërisht të aktit administrativ, duke falur detyrimet e nxjerra sipas procesverbalit nr. 1 (TVSH) \_\_\_\_ lekë, nga të cilat \_\_\_\_ lekë

detyrime dhe \_\_\_\_ lekë gjobë, tatim-fitimi \_\_\_\_ lekë detyrime dhe \_\_\_\_ lekë gjoba, me detyrime të falura në total \_\_\_\_ lekë.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka vlerësuar se paditësi ka kryer shitje me shumicë nëpërmjet faturave tatimore dhe shitje me pakicë nëpërmjet pajisjes fiskale në të njëjtin ambient, vërtetuar kjo me adresën e cila është regjistruar e njëjtë si në faturën tatimore ashtu edhe në pajisjen fiskale. Ky fakt provohet edhe me adresën që shoqëria ka deklaruar në regjistrin tregtar.

Në këto kushte, pala e paditur me të drejtë e ka cilësuar zhvillimin e aktivitetit tregtar, si të kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, gjë e cila dikton nevojën për rivlerësim tatimor, sipas mënyra alternative të vlerësimit.

Për sa më sipër, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse, janë akte të ligjshme, të vlefshme, të nxjerra nga strukturat/ organet kompetente dhe si të tilla duhet të lihen në fuqi.

### **Vendim:**

Gjykata Administrative e Apelit vendosi lëniën në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

## **7. Vendim nr.74, datë 29.01.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** A.P (Person Fizik)

**Të paditur :** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve  
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

**Objekti:** Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative:

- 1.Njoftim vlerësim për detyrimin tatimor nr.\_\_\_\_, datë 06.01.2015;
- 2.Vendim nr.4375/1 prot datë 22.04.2014 i Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Subjekti “A.P” është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me objekt aktiviteti “bar - restorant.....”.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime, tre gjoba në vlerën \_\_\_\_ lekë secila, periudha tatimore 2014/08, dënim për punonjës të padeklaruar vlerësuar për tre raste sipas njoftim-vlerësimit nr.\_\_\_\_ Prot., datë 06.01.2015.

Mbi bazën e informacionit të marrë nga aktet e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër është bërë verifikimi i të gjithë punonjësve të deklaruar si “të punësuar” nga subjekti “A.P”

me NIPT K\_\_\_\_\_B para organit tatimor, për periudhën tatimore 2014/08 dhe nëse deklarimi i këtyre punonjësve është bërë konform kërkesave ligjore.

Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar, se punonjësit e gjendur në punë ditën e konstatimit të bërë, janë deklaruar në organin tatimor nga subjekti, janë përfshirë në deklarinë në Tax-Crm sipas “Listë pagesës së deklaruar” për periudhën tatimore gusht/2014, sipas Formularit “E-Sig 025- Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, por deklarimi i tyre konform kërkesave ligjore është bërë pas konstatimit të bërë dhe jashtë afateve të përcaktuara nga ligji.

Verifikimi është bërë referuar periudhës tatimore kur janë gjendur në punë.

Subjekti duke mos qenë dakord lidhur me vlerësimin e kryer dhe të njoftuar nga ana e DRT Shkodër, i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, e cila ka vendosur: *Refuzimin e ankimit, pasi subjekti nuk kishte përmbushur kërkesat dhe procedurat sipas pikës 106.2.5 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

Tatimpaguesi nuk kishte bashkëlidhur aktin administrativ, njoftim vlerësimin tatimor objekt apelimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.185 datë 29.03.2017, nëpërmjet të cilit vendosi :

- *Pranimin e kërkesë-padisë në këtë mënyrë :*

- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me shkresën nr.\_\_\_\_ Prot., datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për të cilin është refuzuar ankimi nga Drejtoria e Apelit Tatimor me shkresën nr.\_\_\_\_ Prot., datë 22.04.2015, që ka njoftuar detyrime tatimore për palën paditëse- subjektin person fizik A.P.*

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Gjykata Administrative e Apelit çmon, se gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 17 të Ligjit Nr.49/12 ka gabuar në cilësimin e fakteve dhe veprimeve të lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke identifikuar dispozitat e detyrueshme për tu zbatuar prej saj në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, por duke i interpretuar ato në mënyrë jo korrekte.

Gjykata konstaton se, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është reflektim i mosrespektimit të parimeve themelore të zhvillimit të një procesi gjyqësor, sansionuar në Nenet 10 dhe 20 të K.Pr.Civile, të cilët parashikojnë respektivisht se:

*“Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor” dhe “Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit. Ajo mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit”.*

Në rastin në shqyrtim, kontrolli rezulton të jetë kryer në prani të tatimpaguesit/paditësit A.P fakt i pakundërshtuar prej tij. Rrjedhimisht, dijenia e tatimpaguesit/paditësit për kryerjen e kontrollit tatimor për shkak pranë nga njëra anë dhe nënshkrimi rregullisht i aktit respektiv të konstatimit nga ana tjetër, përbëjnë rrethana që ezaurojnë kërkesat procedurale të parashikuara në ligj, lidhur me fazën e përpilimit të akteve tek të cilat bazohet njoftim vlerësimi.

Gjykata Administrative e Apelit nuk konstaton mangësi as në formën e Njoftim Vlerësimit nr\_\_\_\_ Prot., datë 06.01.2015, as për sa i takon pjesës arsyetuese, përfundim që diktohet mbi të gjitha nga fakti i ankimimit të tij në Drejtorinë e Apelit Tatimor. Në këtë kontekst, Gjykata tërheq vëmendjen

mbi faktin se, tatimpaguesi nuk mundet të pretendojë njëherësh mosnjohjen me shkaqet e njoftim vlerësimit si pasojë e të qenurit të tij i paarsyetuar dhe ta ankimojë njoftim vlerësimin administrativisht duke argumentuar të qenurit e shkaqeve të vëna në themel të tij të pabazuara në ligj. Në rastin në shqyrtim, pavarësisht konstatimit të gjykatës së shkallës së parë mbi të qenurit e njoftim vlerësimit nr. \_\_\_\_ Prot., datë 06.01.2015 një akt administrativ i paarsyetuar, Gjykata nuk ka venë re se, kjo mangesi nuk rezulton të jetë bërë pengesë për ankimimin e tij nga paditësi në Drejtorinë e Apelit Tatimor.

Gjykata Administrative e Apelit mbërrin në përfundimin se, padia e bazuar në shkaqe të pavlefshmërisë absolute, rezulton te jete diktuar vetëm nga fakti i mosshterimit të ankimit administrativ, pra të mosplotësimit të njërës prej kushteve formale të padisë, me të cilin barazohet edhe refuzimi i marrjes në shqyrtim të ankimit në kuptim të Nenit 16 të Ligjit Nr.49/2012, i ndryshuar.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, ankimi i palës së paditur përmban shkaqe për ndryshim në favor të saj të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë.

### **Vendim:**

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.74 datë 29.01.2024 vendosi:

- *Ndryshimin e vendimit nr.185 datë 29.3.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*
- *Rrëzimin e padisë.*

### **8. Vendim nr. 607, datë 19.04.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Shoqëria “A” sh.p.k, me NIPT K\_\_\_\_\_

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë  
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

**Objekti:** shfuqizimi i njoftim-vlerësimit për detyrimin tatimor nr. \_\_\_\_ Prot., datë 06.06.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe vendimit nr. \_\_\_\_ Prot., datë 11.07.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Shoqëria “A” sh.p.k me NIPT K\_\_\_\_\_, me aktivitetet: “*Prodhimi dhe tregëtimi i bukës*”, është njoftuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë se ka për të paguar detyrimet në shumën: gjoba \_\_\_\_ lekë, tatim në shumën \_\_\_\_ lekë dhe kamatëvonesa në shumën \_\_\_\_ lekë. Për këtë detyrim subjekti është njoftuar me anë të njoftim-vlerësimit për detyrimin tatimor nr. \_\_\_\_ Prot., datë 06.06.2016.

Shoqëria “A” sh.p.k ka bërë ankim në Drejtorinë e Apelit Tatimor, e cila me vendimin nr. \_\_\_\_ Prot., datë 11.07.2016, ka vendosur: *Refuzimin e ankimit*, me arsyetimin se nga ana e subjektit nuk janë përmbushur kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 107, “Pagesa e detyrimit tatimor,

objekt ankimi”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Konkretisht, nga ana e tatimpaguesit nuk është provuar plotësimi i kushtit të pagesës së detyrimit + kamatëvonesa (pa gjoba).

Sa më sipër, në kushtet ku Drejtoria e Apelit Tatimor ka vendosur refuzimin e ankimit, nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë është bërë kërkesë për mospranimin për shqyrtim të padisë pasi paditësi konsiderohet se nuk ka ezauruar ankimin administrativ ligjërish të detyrueshëm, bazuar kjo në pikën 1, të nenit 16 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se: “Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrative”.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë**

Me vendimin nr. 1956, datë 25.11.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur: “*Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor*”, me arsyetimin se: “ ... nga pala paditëse nuk është shteruar ankimi administrativ dhe si e tillë kjo padi duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor”. Qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim Unifikues nr.3, datë 12.02.2008 dhe nr. 4, datë 30.05.2011.

Rezulton se, ankimi administrativ i paraqitur nga pala paditëse nuk ka përmbushur detyrimin e pagesës dhe me të drejtë DAT nuk ka shqyrtuar ankimin në themel.

Sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se pala paditëse nuk e ka ezauruar ankimin administrativ dhe për këtë arsye, çështja duhet nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor...”.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Gjykata vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Nuk ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, që e bëjnë vendimin të paankimueshëm.

Ankimi nuk rezulton të jetë i plotë pasi nuk rezultojnë të jenë parashtruar të plota shkaqet e ankimit të tij. Ky fakt nuk është konstatuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë e cila me vendimin e datës 02.12.2016 ka vendosur të pranojë ankimin duke urdhëruar dërgimin e ankimit dhe akteve Gjykatës Administrative të Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit ka konstatuar se ankimi përmban të meta dhe ka dalë me vendim të ndërmjetëm për plotësimin e të metave nga paditësi. Pala ankuese nuk ka plotësuar të metat e ankimit.

Sa më sipër, Gjykata ka cmuar se ndodhet në rrethanat e parashikuara në nenet 46, 48 1/1 të ligjit nr. 49/2012, të cilat diktojnë kthimin e ankimit të palës ankuese, pasi nuk janë plotësuar të metat e ankimit.

Në datën 16.10.2017, pala ankuese rezulton se ka hequr dorë nga ankimi saj me shkrim. Kjo kërkesë e palës nuk është marrë në shqyrtim nga kjo gjykatë në kushtet kur ankimi i palës ankuese është me të meta procedurale. Ajo do të merrej në shqyrtim vetëm nëse ankimi i saj nuk do të kishte të meta procedurale.

**Vendim:** Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *Kthimin e ankimit të palës ankuese shoqëria "A" sh.p.k kundër vendimit nr. 1956, datë 25.11.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*

## **9. Vendim nr. 778, datë 09.05.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** Subjekti "A.S" person fizik, me Nipt K\_\_\_\_\_

**Të paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë  
Drejtoria e Apelit Tatimor

**Objekti:** Pavlefshmëri absolute dhe relative e aktit administrativ

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Në bazë të urdhër-shërbimit me nr. \_\_\_\_ Prot., datë 08.08.2016, Inspektorët e Sektorit të Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor kanë ushtruar kontroll në ambeentet e subjektit "A.S" me Nipt K\_\_\_\_\_.

Nga kontrolli i ushtruar referuar akt-konstatimit me nr. serial \_\_\_\_\_, datë 10.08.2016 rezultoi se: *“subjekti është i regjistruar në QKR, është i pajisur me kasë fiskale. Në momentin e kontrollit në punë u gjet A. S, i ditëlindjes 26.04.1984; K.M, e ditëlindjes 10.04.1993; E.M, e ditëlindjes 15.02.1991; E.A, i ditëlindjes 14.03.1996...”.*

Akt konstatimi i mbajtur nga ana e inspektorëve, është përcjellë për zbatim të mëtejshëm në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë. Inspektori i dosjes ka kryer verifikimet në sistemin tatimor C@ts, të listëpagesave si dhe E-SIG027, ku ka rezultuar se:

- *E.M, e ditëlindjes 15.02.1991 dhe E.A, i ditëlindjes 14.03.1996...”, nuk janë deklaruar si punonjës pranë organeve tatimore në momentin e kontrollit.*

Në bazë të konstatimit, është mbajtur dhe Proces-Verbal Gjore me nr. serial \_\_\_\_ datë 19.08.2016, ku në bazë të nenit 119, të ligjit 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, subjekti është penalizuar me gjobë 2x500.000 (pesëqind mijë) lekë = 1.000.000 ( një milion) lekë, për dy punonjës të pa deklaruar.

*Për këto penalitete subjekti është njoftuar nëpërmjet njoftim-vlerësimit nr. \_\_\_\_ Prot., datë 22.09.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.*

*Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë*

Me vendimin nr. 349, datë 08.03.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova”.*

*Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim pala paditëse më të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë.*

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Çështja që shtrohet për zgjidhje pranë kësaj gjykate është nëse akti administrativ, objekt gjykimi, është apo jo akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Gjykata Administrative e Apelit në arsyetimin e saj i është referuar nenit 108 të K.P.Administrative, në të cilin janë parashikuar rastet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ.

Përsa i përket kompetencave të palës së paditur për nxjerrjen e akteve administrative objekt gjykimi, Gjykata konstaton se, neni 119 i ligjit nr. 9920/2008 i ndryshuar parashikon detyrimin e tatimpaguesit që të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës, të deklaroj personat e punësuar. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga tatimpaguesi pasjell të drejtën e administratës tatimore që ta gjobisë me shumën 50.000 lekë, për punonjës të padeklaruar, bazuar në nenin 119 të ligjit. Pra, mbështetur në këtë dispozitë pala e paditur ka qenë kompetente nga pikpamja lëndore dhe tokësore për nxjerrjen e aktit administrativ, objekt gjykimi.

Në lidhje me procedurën e nxjerrjes së aktit administrativ objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se kjo procedurë është respektuar. Konkretisht, administrata tatimore ka ushtruar kontroll tatimor ndaj subjektit "A.S", ku kanë mbajtur akt-konstatimin me nr. serial \_\_\_\_\_, datë 10.08.2016 dhe Procesverbal gjobe me nr. serial \_\_\_\_\_, datë 19.08.2016, sipas nenit 119 të ligjit nr. 9920/2008, i ndryshuar.

Këto akte, përvec se janë mbajtur në vend-biznesin e palës paditëse, rezultojnë që ti jenë njoftuar atij. Pra, nga tërësia e kësaj veprimtarie administrative, gjykata vlerëson se pala e paditur ka respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor, të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter administrativ. Për rrjedhojë, pretendimet e paditësit se janë shkelur parimet e KPr.Administrative janë të pabazuara.

Akti administrativ, objekt ankimi është në formën e shkruar, cka do të thotë se forma e nxjerrjes së aktit administrativ është respektuar.

Akti objekt gjykimi nuk është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes etj.

Sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar se akti administrativ, objekt gjykimi, nuk është akt administrativ abasolutisht i pavlefshëm, sic ka pretenduar pala paditëse.

Përsa i përket pretendimeve për paligjshmëri ka rezultuar se njoftim-vlerësimi objekt ankimi është nxjerrë bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008, si dhe udhëzimit dalë në zbatim të tij. Në rastin konkret, paditësi ka kryer veprime/ mosveprime në kundërshtim me nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008 pasi në momentin e kontrollit janë gjetur punonjës të padeklaruar në organin tatimor një ditë kalendrike përpara fillimit të punës dhe me të drejtë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka disponuar me lënien në fuqi të njoftim-vlerësimit objekt ankimi të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë.

**Vendim:** Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 349, datë 08.03.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*

## **10. Vendim nr.973, datë 06.12.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës :** Shoqëria “A.P”

**Të paditur :**Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM)/ Drejtoria e Apelimit Tatimor

**Objekti i padisë:** shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ- njoftim-vleresimit nr.\_\_\_\_ Prot., datë 07.03.2016, të DTM-së

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Nga kontrolli i shitjeve për muajin nëntor 2013 është konstatuar se shoqëria nuk ka lëshuar kupon tatimor për shitjet e deklaruar. Sipas të dhënave të sistemit tatimor nexus rezulton se shoqëria me datë 30.11.2013 ka 46 kasa të fiskalizuara dhe nuk ka lëshuar kupon tatimor.

Nga bilanci material për periudhën Janar –Qershor 2015 janë konstatuar diferenca negative në shumën \_\_\_\_\_ lekë dhe penalitet në shumën \_\_\_\_\_ lekë , referuar nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:**

Pajisjet fiskale bëjnë regjistrimin e të dhënave për vlerën e mallrave dhe shërbimeve për klientët, në shiritin e kontrollit elektronik dhe në memorien fiskale, duke siguruar në këtë mënyrë gjenerimin e raporteve të veçanta, referuar kjo VKM-së nr. 781, datë 14.11.2007, të ndryshuar, pika 9.1. *“Pajisja fiskale dërgon në mënyrë automatike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të dhënat fiskale ditore mbas mbylljes së raportit tatimor ditor. Në rastet kur transmetimi nuk realizohet, pajisja fiskale i ridërgon raportet tatimore ditore të patransmetuara në mbylljen e raportit tatimor ditor të ardhshëm. Për transmetim të dhënash pas këtij afati aplikohen penalitetet e përcaktuara në nenin 113 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

Kjo Gjobë për moslëshim kuponi tatimor duhet të vërtetohet jo të prezumohet, sikurse ka bërë grupi i kontrollit duke iu referuar parimisht numrit të kasave fiskale të regjistruara prej shoqërisë.

Pavarësisht faktit se grupit të kontrollit nuk i është vënë në dispozicion ky informacion, i cili është paraqitur vetëm gjatë gjykimit, Gjykata nuk mund të penalizojë për një shkelje e cila nuk është vërtetuar.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr.6021, datë 15.12.2016, ku është vendosur:

- Pranimi pjesërisht i kërkesëpadisë të shoqërisë "A.P" duke shfuqizuar Njoftim-Vlerësimin për gjobën \_\_\_\_\_ lekë dhe TVSH 2015 në vlerën \_\_\_\_\_, penalitet në vlerën \_\_\_\_\_ lekë.
- Shfuqizimin e Njoftim-Vlerësimit në vlerën \_\_\_\_\_ lekë.

## **11. Vendim nr.1077, datë 18.12.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit**

**Paditës:** "I.S.P" sha

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj

**Objekti:** Shfuqizimi i njoftim vlerësimit tatimor nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë 14.05.2008; Shfuqizim i vendimit nr 7070/2 Prot., datë 30.06.2008, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor dhe vendimit nr. 538, datë 01.08.2008, të Komisionit të Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore.

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Nga kontrolli i shpenzimeve për vitin 2003/2005/2006/2007 është konstatuar se në zërin "Furnitura, nëntrajtme dhe shërbime", kanë rezultuar shpenzime me dokumentacion të parregullt justifikues.

Nga kontrolli i llogarisë "Humbje nga mosarkëtimi i debitorëve", rezultoi se kjo humbje në shumën prej \_\_\_\_\_ lekë është pjesë e provigjionit të kredive të këqija të cilat janë fshirë plotësisht nga librat e kreditit të shoqërisë. Pasqyrimi i këtyre shpenzimeve në zërin "Humbje nga mosarkëtimi i debitorëve" dhe trajtimi i tyre si borxh i keq është shpenzim i panjohur për efekt fiskal në kuptim të kërkesave të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Inspektorët e kontrollit pasi kanë kontrolluar ligjshmërinë e përfshirjes në shpenzimet e zbritshme (të njohura) të bilanceve për vitet ushtrimore 2003-2007 për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, kanë konstatuar se nga ana e paditësit në zërin e shpenzimeve janë përfshirë humbjet nga mosarkëtimi i debitorëve (kreditë e këqija) të cilat janë fshirë plotësisht nga librat e kreditit të shoqërisë.

Humbjet nga mosarkëtimi i debitorëve, përfshirjen e tyre në shpenzimet e ushtrimeve dhe trajtimin e tyre si borxh të keq, i kanë konsideruar si shpenzime të panjohura për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm.

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

Humbjet nga mosarkëtimi i debitorëve, përfshirjen e tyre në shpenzimet e ushtrimeve dhe trajtimin e tyre si borxh të keq, inspektorët e kontrollit me te drejtë i kanë konsideruar si shpenzime të panjohura për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, në zbatim të neneve 21 e 24 të ligjit nr 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe udhëzimit nr 5 datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Praktikisht që një borxh të trajtohet si borxh i keq, kërkohet që të jenë kryer të gjitha veprimet për rikuperimin e tij dhe kur janë marrë vendime gjyqësore (psh në rastin e deklarimit të falimentit) apo organeve të tjera kompetente (psh deklarimi i zyrës së përmbartimit se debitori nuk ka asete apo të ardhura mbi bazë të të cilave do të ekzekutohet për rikuperim të kredisë). Nëse për cdo rast, një shumë e njohur më parë si borxh i keq, arkëtohet gjatë vitit korent, kjo shumë përfshihet në të ardhurat e këtij viti. Rrjedhimisht, ai borxh i keq tatohet vetëm njëherë, në momentin e

arkëtimit të tij. Pala paditëse nuk ka zbatuar drejt legjislacionin e aplikueshëm për njohjen e shpenzimeve të zbritshme duke mos zbatuar procedurat ligjore të borxhit të keq për kreditë e fshira.

**Vendim:**

Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me nr.1342, datë 18.03.2016, duke rrëzuar kërkesëpadinë e shoqërisë “I.S.P” sha.